

Çështje të edukimit dhe të zhvillimit të fëmijës: Menaxhimi i sjelljes

Proçedura e të mësuarit së «sjelljes së mirë» është një proçedurë e vështirë, gjatë së cilës prindi ftohet shumë herë të përmbajë nervat dhe të masë durimin e tij. Nga ana tjetër, asnjë fëmijë nuk 'heq dorë' lehtë kur kërkon realizimin e një dëshire të tij. Pra, prindi duhet të njohë disa mënyra që do ta ndihmojnë të menaxhojë «sjelljet e vështira» të fëmijës së tij.

Mësoj
rreth
fëmijës

Ka dy pyetje që duhet t'i drejtojë vetes një prind, të cilat kanë të bëjnë me fëmijën e tij:

- 1) Dua një fëmijë «të lehtë» dhe/ose një fëmijë të bindur si «ushtar»? dhe
- 2) Sa herë që fëmija im sillet në kundërshtim me sjelljen që unë dua, a mendoj pse sillet kështu? A kërkoj shkaqet e kësaj sjelljeje?

Përgjigjja e drejtë për pyetjen e 1-rë, (nëse një prind do një «fëmijë të lehtë» apo një të bindur si «ushtar»), është se: asnjë nga të dy rastet nuk është psikikisht i dobishëm për fëmijën.

«Fëmija i shëndetshëm emocionalisht» është ai që kërkon të plotësojë dëshirat e tij, por paralelisht njeh dhe u përmbahet caqeve që i vënë prindërit!!!

Pyetja e 2-të, (nëse prindi kërkon shkakun që fshihet pas sjelljes së fëmijës), nënkupton një prind që interesohet për fëmijën e tij në tërësi; si për shëndetin ashtu dhe për ekuilibrin e tij emocional.

Prindi gjithmonë duhet të mendojë: «Pse fëmija im sillet kështu? Çfarë gabimi është bërë dhe çfarë mund të bëj që ta korrigjoj?».

Çfarë bëj si prind, kur fëmija im është i nevrikosur?

- Nuk filloj t'i bërtas dhe unë.
- E pyes qetë çfarë e shqetëson apo çfarë e shqetësoi.
- I shpjegoj qetë se me të bërtitura dhe me veprime të nxehura (p.sh. hedhja e sendeve, shkelmat, të shtyrat, e.t.j.) nuk mund të gjejmë zgjidhje dhe të vetmen gjë që arrijmë është të vazhdojmë të jemi të nevrikosur.
- Kur fëmija duket se është qetësuar, e përqafoj dhe bisedoj me të për çka i provokoi kaq shqetësim të madh.
- Edhe pse fëmija vazhdon të ketë nerva dhe t'i shfaqë me forcë, i shpjegoj se do të merrem me të vetëm kur të pushojë së sjelluri kështu dhe largohem nga ambienti. Vij përsëri vetëm kur fëmija qetësohet dhe bashkëbisedoj me të. Mirë është që kurdo që fëmija sillet i nevrikosur, të sillemi me të njëjtën mënyrë kundrejt tij.



Çfarë bëj si prind kur fëmija im është i pavemendshëm (kur i flas, kur ndodhet me njerëz të tjerë, kur bën mësimet e tij, e.t.j.), kur fëmija ka humbur gjallërinë e tij ose kur ndryshon shpesh qefin e tij?

- Mendoj nëse mund ta shqetësojë ndonjë ngjarje që ka të bëjë me jetën e familjes (p.sh. mungesa e një personi, kontradikta, sëmundje, udhëtime, lindje), dhe e diskutoj me të qetë. Gjithësesi, nuk duhet të ketë kërkesa stresuese nga ana e prindit, në mënyrë që të nxjerrë ato që dëshiron nga fëmija i tij.
- Nëse fëmija nuk ka dëshirë të flasë, përpiqem përsëri pas disa ditësh dhe gjithashtu vërej nëse ka edhe ndryshime të tjera në sjelljen e tij (p.sh. në ushqim, në gjumë, nëse fle më lehtë, nëse nxehet më shpesh, nëse shmanget të luajë me fëmijë të tjerë, e.t.j.).
- Këshillohem me mësuesin/en e fëmijës duke mësuar si sillet në shkollë dhe nëse është nevoja bashkëpunoj me të ose me ndonjë specialist.

Çfarë bëj kur fëmija im më «kundërvihet»?

- I shpjegoj se kjo sjellje nuk të çon në një zgjidhje të mirë dhe se e kuptoj shqetësimin e tij. Bisedoj qetë me të lidhur me çështjen për të cilën është nxehur.
- I kërkoj të më shpjegojë pse nuk është dakort me atë që i them apo i kërkoj.
- Nëse kundërshtimi i tij shprehet me sharje, i shpjegoj se nuk është kjo mënyrë të shprehuri për të shfaqur kundërshtimin ose zemërimin tonë. Qëndroj i/e qetë dhe bisedoj me të deri sa të gjendet një zgjidhje në kontradiktën tonë.

Çfarë bëj kur fëmija im bëhet agresiv (në shkollë, në shtëpi), apo është shumë i pabindur?

- Mendoj se shpeshherë një fëmijë reagon në këtë mënyrë që të tërheqë vëmendjen. Atëherë pyes veten mos unë apo prindi tjetër e kemi lënë pas dore kohët e fundit.
- Mendoj se që të sillet kështu me siguri e shqetëson ose është nxehur me diçka. Atëherë e pyes e/i qetë, por me këmbëngulje çfarë ka ndodhur.
- I shpjegoj se sjellja agresive nuk është zgjidhje, se është më mirë ta kërkojmë qetë atë që duam nga tjetri dhe se tjetri ka të drejtën e kundërshtimit. I kujtoj gjithashtu se sjellja agresive provokon dhunë dhe kjo nuk është diçka që më pëlqen, nëse ai vetë ka pranuar se është agresiv.
- Kujdesem që në shtëpi të ketë harmoni midis anëtarëve të familjes dhe bëj shpesh biseda për të treguar sa e çmuar është qetësia në marrëdhëniet njerëzore.
- Bashkëpunoj me mësuesin/en për dhunën apo mosbindjen në shkollë.

Çfarë bëj kur fëmija im vjedh «gjëra të vogla»?

- Mendoj se kjo sjellje tregon se fëmija im dëshiron të ketë gjëra që mua nuk m'i kërkon dot, pra bisedoj me të dhe i shpjegoj se nuk mund të ketë gjithçka që dëshiron.
- Mendoj se fëmija im do më shumë dashuri dhe vëmendje nga sa i tregojmë si familje.
- I kërkoj vazhdimisht që ditën tjetër t'i kthejë ato që mori dhe kontrolloj nëse e ka bërë apo jo.

Çfarë bëj kur fëmija im ka shumë ankth për mësimet, për notat e tij, kur vështirësohet të thotë mësimin edhe pse ka lexuar, (p.sh. dridhet, harron, qan, «laget», vjell)?

- Pyes veten nëse unë, si prind, ushtroj presion që të jetë nxënës/e i/e mirë.
- Ndryshoj qëndrimin tim për sa i përket kërkesave të mia për shkollën, d.m.th. bëhem më elastik/e (p.sh. nuk e qortoj nëse nuk ka lexuar mirë mësimin e tij, por e ndihmoj ku të ketë nevojë, i them se nëse përpiqet mund t'ia arrijë, se besoj në aftësitë e tij, e.t.j.).
- I shpjegoj se ka të drejtën e dështimit dhe se nuk u prish bota nëse kjo ndodh, sepse është e rëndësishme që përpiqet.
- Lexoj me të dhe e lavdëroj në çdo përpjekje të tij.
- Kërkoj ndihmën e mësuesit/es të/së tij dhe bashkëpunoj me të.

Çfarë bëj kur fëmija im refuzon të lexojë ose ndryshon qëndrimin e tij ndaj të lexuarit?

- Kujdesem që të mos ushtroj presion të madh që të lexojë.
- I shpjegoj sa e nevojshme është që njerëzit të jenë të shkolluar.
- Me ndihmën e specialistit/es ose të mësuesit/es përpiqem ta bëj orën e të mësuarit më të këndshme, (p.sh. t'i them ngjarje nga jeta ime shkollore, të luaj me të në pushim të leximit, të krijoj një ambient të këndshëm, të pastër dhe të qetë, i cili do të jetë dhe këndi i tij për të lexuar).
- Përpiqem të kuptoj nëse fëmija nuk lexon, është i stresuar – pyes nëse ka diçka që e streson ose nëse unë bëj diçka që i krijon ankth.
- Bëj me të programin e leximit dhe e kontrolloj nëse e mban duke lexuar bashkë me të, duke e lavdëruar për çdo sukses të tij të vogël.



Enti zbatues

POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsim dhe në Shoqëri



www.polydromo.gr
polydromo@polydromo.gr

Autore teksti

Haidis Elena, PhD Psikologe Terapia e njohjes së sjelljes

Koordinatorë të programit

Birbili Maria – Cokalidhu Rula

Departamenti i Shkencave të Edukimit

dhe të Arsimit Parashkollor
Universiteti Aristoteli Selanik

Website: www.polydromo.gr/dialogos

Përkthyes

Valbona Hystuna /Përpunuan tekstin Evi Marku

Me mbështetjen e

